

INFINITO

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

INFINITO është fungicid me veprim kontakti e sistemi për kontrollin e vrugjeve në patate e perime. -**Propamocarb hydrochloride** ka veprim sistematik dhe është inhibitor i shumeanshem. Kur përdoret me trajtime gjethore në patate e perime, leviz lart dhe përhapet në gjethë. Është efektiv ndaj shkaktareve të vrugjeve si: *Peronospora*, *Pseudoperonospora*, *Phytophthora spp* dhe *Bremia* si dhe kalbezimit të qafes së fidanit *Pythium spp*.

-**Fluopicolide** ka veprim kontakti dhe levizje translaminare në bime. Deperton nga ana e sipërme e gjethes në anën e poshtme dhe anasjellas. Në bime leviz nepermjet ksilemes. Nga baza e gjethes shpërndahet shpejt në të, por nuk leviz nga një gjethë në tjetrën. Në hardhi, gjethet e dala nga një syth në celje të trajtuar, janë të mbrojtura. Është efektiv për kontrollin semundjeve të shkaktuara nga kerpudhat Oomycete (Phycomycete) si *Plasmopara*, *Pseudoperonospora*, *Peronospora*, *Bremia*, *Phytophthora* si dhe *Pythium*. Ka veprim parambrojtes, por edhe antispurulant. -**Infinito**, si kombinim i të dy lendeve aktive, ka veprim kontakti dhe sistemi. Duhet të përdoret në trajtime parambrojtëse.

Përmban: *Propamocarb hydrochloride 55.6% (625 g/l) + fluopicolide 5.6% (62.5 g/lit);*

Formulimi: *Koncentrat i suspensueshem (SC);*

Pamja: *Leng me ngjyrë bezhe.*

Frazat e rrezikut dhe kujdesit:

H317 Mund të shkaktojë një reaksion alergjik lëkure.

H410 Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata.

EUH401 Për të shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorimin.

P270 Mos hani ushqim, pini lëngje ose pini duhan kur përdorni këtë produkt.

P280 Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën/sytë.

P333+P313 Nëse ndodh irritimi ose skuqja lëkurës: Merrni këshilla/ vëmendje mjekësore.

P391 Mblidheni atë që derdhet. P501 Asgjësoni kontejnerin sipas rregullave në fuqi.

Masat parambrojtëse:

- Evitoni kontaktin e produktit me lëkurën dhe sytë.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Gjate punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.
- Para fillimit të punës vishni rrobat e punës dhe paisjet mbrojtëse
- Lani duart dhe pjesët e ekspozuara të lëkurës me ujë dhe sapun.
- Pas përfundimit të punës lani të gjitha paisjet.
- Ambalazhi bosh të asgjësohet sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast marrje me organet e frymëmarrjes, nxirëni të dëmtuarin në ajër të pastër. Nëse simptomat vazhdojnë, kërkon ndihmë mjekësore.
- Në rast kontakti me lëkurën, hiqni rrobat e ndotura, lani menjëherë pjesët e kontaminuara me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Në rast kontakti me sytë, shplajini ata me ujë të bollshëm. Konsultojuni me mjekun.
- Në rast se produkti është gëlltitur mos shkaktoni tërë vjella. Shpërlani gojën dhe kërkon ndihmë mjekësore. Jepini të dëmtuarit qymyr aktiv.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi sipas simptomave. Ky produkt, megjithatë është karbamat, nuk është inhibitor i kolinesterazës.
- Kunderindikacioni: Atropina

Përdorimi:

Perdoret per kontrollin e **vrugjeve** ne patate e perime.

- Ne **patate**, per kontrollin e vrugut (*Phytophthora infestans*) perdoret nga faza kur filizi bazal eshte me i vogel se 5 cm deri ne fazen kur fillon zverdhja e gjetheve (BBCH 20-92). Perdoret 1.2-1.6 lit produkt/ha, ne 200-600 lit uje.
- Ne **perime (domate, qepe, laker, lulelaker, pras, spinaq, trangull, shalqin, pjeper)**, per kontrollin e vrugjeve perdoret 1.4-1.6 lit produkt/ha, ne 400-1000 lit uje.

Vërejtje për përdorimin:

Volumi i tretesires sperkatese duhet te jete i mjaftueshem per te siguruar lagie te mire te mases gjethore.

Perdoret i alternuar me produkte te tjera me mekanizem te ndryshem veprimi, per te evituar cfaqjen e rezistences. Me kete product mund te behen deri 4 trajtime ne sezon.

Trajtimet perseriten çdo 7-10 dite, ne vartesi te infeksionit.

Fitotoksiciteti:

Nuk eshte fitotoksik nese perdoret sipas rekomandimeve.

Ndikimi në ekosistem:

Është shumë toksik për organizmat ujore, mund të shkaktojë efekte të këqia afatgjata në mjediset ujore. Mos ndotni ujrat dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji.

Karenca:

Patate dhe qepe 7 dite; laker, lule laker, pras, spinaq 14 dite; trangull, domate, shalqin, pjeper 3 dite.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruhet në vende të thata, të ajrosura, larg rrezeve direkte të diellit, në temperaturë 0-40^o C.

Nr dhe data e regjistrimit: 190; 26.2.2010;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 1000 ml.

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit baze: shishe COEX PE/EVOH;

Emri dhe adresa e Aplikantit: Bayer CropScience AG. **Adresa:** Monheim, Gjermani;

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Bayer CropScience AG. **Adresa:** Monheim, Gjermani;

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):